



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr.32/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj -anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.06.2026, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuar ankesat ZP.Anr.32/2026, ZP.Anr.33/2026, ZP.Anr.40/2026, ZP.Anr.41/2026, ZP.Anr.42/2026 të datës 09.06.2026, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Me datë 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZP.Anr.32/2026, ZP.Anr.33/2026, ZP.Anr.40/2026, ZP.Anr.41/2026, ZP.Anr.42/2026 të datës 09.06.2026 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

Në ankesën ZP.Anr.32/2026 pretendohet se më datë 07.06.2026, rreth orës 11:00, në ditën e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik PDK për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Naim Telaku, në rrjetet sociale ka publikuar një video (reklamë aktive) me përshkrimin: #PDK #Bedri Hamza Kryeministër #NaimTelaku #55. Me këtë veprim, kandidati i lartcekur dhe subjekti politik të cilit i përket kanë shkelur dispozitat e nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore gjatë ditës së heshtjes zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur

video dhe fotografi të postimit në rrjetet sociale [https://www.facebook.com/shai*e \(p / 1 BNDuW6s2M/](https://www.facebook.com/shai*e (p / 1 BNDuW6s2M/)

Në ankesën ZP.Anr.33/2026 pretendohet se më datë 07.06.2026, rreth orës 11:00, në ditën e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik PDK për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Nura, në rrjetet sociale ka publikuar një video (reklamë aktive) me peshkimin: "#Stop Krizës #PDK125 #JakupNura11". Me këtë veprim, kandidati i lartcekur dhe subjekti politik të cilit i përket kanë shkelu dispozitat e nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore gjatë ditës së heshtjes zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur Video dhe fotografi të postimit në rrjetet sociale. <https://www.facebook.com/share/v/I DHBks PzUM/>

Në ankesën ZP.Anr.40/2026 pretendon se më datë 07.06.2026, rreth orës 13:00, në ditën e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë vërejtur se kandidatja e subjektit politik PDK për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Dafina Broçi në rrjetet sociale ka publikuar (reklamë aktive) me foto duke i ftuar qytetarët të votojnë për të dhe partinë që përfaqëson. Provë ka bashkangjitur fotografi të postimit në rrjetet sociale facebook. Me këtë veprim, kandidatja e lartcekur dhe subjekti politik të cilit i përket kanë shkelur dispozitat e nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore gjatë ditës së heshtjes zgjedhore.

Në ankesën ZP.Anr.41/2026 pretendon se më 07.06.2026, rreth orës 13:00, në ditën e heshtjes zgjedhore, aktivistët e LVV kanë vërejtur se kandidatja e subjektit politik PDK, Fazlie Bektoshi në rrjetet sociale ka publikuar reklamë aktive me foto duke i ftuar qytetarët që ta votojnë për të dhe partinë që e përfaqëson. Ky veprim sipas parashtresës të ankesës bie ndesh me nenin 37, par.1., nenpar.1.2., të LZP-së i cili ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore gjatë ditës së heshtjes zgjedhore. Si provë në ankesë, LVV ka bashkangjitur fotografi të postimit në rrjetet sociale "Facebook".

Në ankesën ZP.Anr.42/2026 pretendon se më datë 07.06.2026, në ditën e votimit dhe gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, më 07.06.2026, rreth orës 13:00, në ditën e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! kanë vërejtur se kandidati i subjektit politik PDK për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Elmi Fazliu, në rrjetet sociale ka publikuar një shkrim (reklamë aktive) me foto duke i ftuar qytetarët të votojnë për të dhe partinë që përfaqëson. Me këtë veprim, kandidati i lartcekur dhe subjekti politik të cilit i përket kanë shkelur dispozitat e nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon zhvillimin e fushatës zgjedhore gjatë ditës së heshtjes zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur screenshot të fotografisë.

Andaj, duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e paraqitura më sipër, kërkon që ndaj subjektit politik PDK dhe kandidatëve të përmendur të shqiptohen masa përkatëse sanksionuese në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në përgjigje në ankesë të subjekti politik PDK lidhur me ankesat ZP.Anr.32/2026, ZP.Anr.33/2026, ZP.Anr.40/2026, ZP.Anr.41/2026 dhe ZP.Anr.42/2026 theksojnë se, subjekti politik PDK ka ndërmarrë veprime konkrete për informimin e kandidatëve lidhur me rregullat zgjedhore dhe me sjelljen e ndaluar gjatë fushatës dhe gjatë ditës së zgjedhjeve.

Më datë 15.05.2026, menjëherë pas certifikimit të kandidatëve, PDK ka mbajtur Sesion Informues me kandidatët për deputet, ku ndër të tjera janë trajtuar udhëzimet ligjore, për obligimet e kandidatëve gjatë fushatës, veprimet e ndaluara, rregullat për financimin e fushatës, monitorimin e sponsorizimeve dhe ndalesat gjatë ditës së zgjedhjeve.

Po ashtu, secili kandidat ka nënshkruar Deklaratë me të cilën është pajtuar të respektojë Kodin e Etikës, Ligjin Për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullat e fushatës, Materialet dhe udhëzimet për mënyrën e sjelljes Gjatë fushatës, përfshirë edhe ndalesat gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit, u janë dërguar kandidatëve përmes email-it, më datë 16.05.2026. Këto veprime dëshmojnë se PDK ka krijuar mekanizëm paraprak të informimit dhe parandalimit të shkeljeve, në përputhje me standardin e nenit 33 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme,

Më datë 06.06.2026, një ditë para zgjedhjeve, nga kandidatët është kërkuar që të ndalen sponsorizimet dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme me menaxherët e faqeve përkatëse, në mënyrë që të respektohen rregullat e heshtjes zgjedhore dhe ndalesat e ditës së votimit. Kjo kërkesë është dërguar para ditës së zgjedhjeve dhe përbën veprim konkret parandalues nga subjekti politik PDK.

Pas pranimit të ankesave, secili prej kandidatëve ndaj të cilëve është parashtruar ankesë ka përpiluar deklaratë me datë 09.06.2026. Në këto deklarata kandidatët kanë theksuar se Gjatë ditës së zgjedhjeve nuk kanë bërë postime të reja; se pas kërkesës së shtabit kanë kërkuar nga menaxherët e faqeve të tyre që të ndalen sponsorizimet; se e kuptojnë rëndësinë e respektimit të rregullave zgjedhore dhe janë përpjekur t'i respektojnë ato; si dhe se çdo shfaqje eventuale e reklamës pas ndaljes së sponsorizimit mund të ketë ardhur si rezultat i vazhdimit automatik të platformës për shkak të fondeve të mbetura, pa dijeninë dhe autorizimin e tyre.

Sipas përgjigjes në ankesë, nuk qëndron pretendimi i ankuesit se vetëm nga fotografia apo nga shënimi "reklamë aktive" mund të nxirret përfundimi se kandidati dhe subjekti politik PDK-së kanë zhvilluar fushatë në ditën e zgjedhjeve. Reklamimi në rrjetet sociale funksionon përmes mekanizmave teknik të platformës edhe pas kërkesës për ndalje, është e mundur që për shkak të fondeve të mbetura, konfigurimeve të llogarisë apo kohës së përpunimit nga platforma, një përmbajtje të vazhdojë të shfaqet për një periudhë të caktuar pa urdhër, dijani apo veprim të kandidatit. Përgjegjësia zgjedhore duhet të vlerësohet mbi veprimet konkrete të subjektit dhe kandidatit, mbi dijeninë e tij dhe mbi masat parandaluese të ndërmarra, jo vetëm mbi një gjendje teknike të shfaqur në platformë, në këtë rast rrjetin social Facebook.

Këto prova materiale tregojnë qartë se PDK ka vepruar me kujdesin e nevojshëm institucional dhe se nuk ka nxitur, shtyrë apo përkrahur asnjë shkelje të rregullave zgjedhore. Më tej theksojnë se ankesa e LVV-së nuk e plotësojnë standardin e mjaftueshëm provues për shqiptimin e masës ndaj PDK-së apo kandidatëve të saj. Ankuesi nuk ka provuar postim të ri

në ditën e zgjedhjeve, nuk ka provuar urdhërim të sponsorizimit pas hapjes së qendrave të votimit, nuk ka provuar dijëni të kandidatëve për ndonjë vazhdim eventual teknik të reklamimit dhe nuk ka trajtuar masat parandaluese të ndërmarra nga PDK.

Kërkon nga PZAP-i që ankesat e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje të refuzon si të pabazuar, nga provat e paraqitura të vërtetohet se Partia Demokratike e Kosovës apo kandidatet, Naim Telaku, Jakup Nura, Dafina Broçi, Fazlie Bekteshi dhe Elmi Fazliu nuk kanë bërë postime të reja, sponsorizime të reja, apo se kanë zhvilluar fushatë në ditën e votimit si dhe të konstatohet se PDK ka ndërmarrë masa paraprake dhe serioze për informimin, udhëzimin dhe parandalimin e shkeljeve nga kandidatët. Si provë ka bashkangjitur: Agjenda e Sesionit Informues me kandidatët për deputet, e datës 15.05.2026; Deklaratat e kandidatëve për respektimin e Kodit të Etikës dhe rregullave zgjedhore; Materialet dhe udhëzimet e përcjella kandidatëve më datë 16.05.2026; Komunikimi/udhëzimi i datës 06.06.2026 për ndaljen e sponsorizimeve, deklarata e kandidatëve të lartpërmendur si në ankesë.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.32/2026, ZP.Anr.33/2026, ZP.Anr.40/2026, ZP.Anr.41/2026 dhe ZP.Anr.42/2026, të paraqitura me datë 09.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.Anr.32/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

- Ankesat janë të e pa bazuara

Parashtruesi i ankesave subjekti politik LVV në ankesat e tij ka theksuar se kandidatët për anëtarë të Kuvendit të Kosovës, nga radhët e subjektit politik PDK, Naim Telaku, Jakup Nura, Dafina Broçi, Fazlie Bekteshi dhe Elmi Fazliu, se më datë 07.06.2026, gjatë orës 11:00 dhe 13:00, në ditën e heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës përmes mekanizmit të pagesës së platformës së sponsorizuar në rrjetet sociale kanë publikuar (reklama aktive) dhe kanë shpërndarë foto dhe video me përmbajtje politike duke i ftuar qytetarët të votojnë për ta dhe partinë që përfaqësojnë.

Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të nenit 37 par. 1 pika 2 i LZP-së.

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."* ndërmori hetim

lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesave dhe gjeti se të njëjta janë të pa bazuara, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social Facebook nuk ka gjetur se kandidatët e lartcekur të kenë bërë publikimet me datën 07 Qershor 2026 në ditën e votimit.

Në rastin konkret nga provat e prezantuara nga ankuesi në provat e bashkangjitura si dëshmi nuk shihet ndokund data 07 Qershor 2026 për të cilën pretendohet si datë e publikimit të shfaqjes në rrjetet sociale Facebook të kandidatëve Naim Telaku, Jakup Nura, Dafina Broçi, Fazlie Bekteshi dhe Elmi Fazliu, meqenëse nuk është dëshmuar nga ankuesi data e publikimit të shfaqjes, por se të njëjta janë të postuar para ditës së votimit dhe me këtë rast Paneli nuk ka gjetur shkelje të nenit 37 par. 1 pika 2 i LZP-së.

Paneli, vlerësoi se ankesat janë të pabazuara, pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur ankesës, nuk është arritur të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara për të cilën referohet pala ankuese.

Pala ankuese nuk ka ofruar prova se ka pasur postim të ri në ditën e zgjedhjeve, nuk ka provuar urdhërim të sponsorizimit pas hapjes së qendrave të votimit dhe nuk ka provuar dijeni të kandidatëve për ndonjë vazhdim eventual teknik të reklamimi.

Paneli pas hetimit të bere dhe nga provat e administruara ka vërtetuar se kandidatet e lartcekur postimet i kishin bere gjate fushatës zgjedhore respektivisht disa dite para ditës se zgjedhjeve dhe fillimit të heshtjes zgjedhore, ndërsa gjate heshtjes zgjedhore kandidatet e apostrofuat si me lart nuk kane pasur ri postim, ri publikim, shpërndarje apo promovim ne llogarit e tyre ne platformën sociale. Fakti qe postimet e bëra dite me pare kane mbetur ende aktive edhe ne ditën e zgjedhjeve nuk nënkupton se është thyer heshtja zgjedhore.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 par. 1 të Ligjin Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.32/2026 më datën 11.06.2026

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.